



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
26.10.2023**

Me datë 26.10.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkoçaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Artan Haxhi, Elmira Ndrevasaj, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Blendi Gjylbegaj, Gloria Shllaku, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2023".*
2. Pr/ Vendim: *"Për emërimin e Drejtorit të Teatrit Migjeni"*
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane (MNU) Bashkia Shkodër"*
4. Pr/Vendim: *"Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër"*
5. Pr/Vendim: *"Për dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim të një sipërfaqe prej 602 m²(kati parë) dhe 602 m²(kati dytë) objekti "ish Konvikti Safet Spahiu", në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e Qarkut Shkodër"*
6. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023"*
7. Pr/Vendim: *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*

8. Pr/ Vendim: "Për disa ndryshime në VKB nr.27, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër"i ndryshuar
9. Pr/ Vendim: "Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me VKB Nr.71 datë 27.12.2022 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër"
10. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të "Agjencia Rrenc" me nr.pasurie 19/2, ZK 3168, indeks hartë K-34-64-(210-B), me sipërfaqe prej 31,165m², nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër".
11. Pr/ Vendim: "Për krijimin e komisionit të përkohshëm të Këshillit bashkiak Shkodër, "Për kriteret dhe procedurën e dhënies së titujve vendorë të nderit dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë
12. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Luli, kryetari i Këshillit lexon rendin e ditës duke shtuar edhe pikën shtesë në rendin e ditës vjen: *Pr/Vendim:Për një ndryshim në VKB nr.71 datë. 27.10.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër"i ndryshuar.*

Z.Bjanku merr fjalën dhe shprehet se në mendimin e tij ka problem me procedurën në disa pika të rendit të ditës, për më tepër kanë ardhur vonë duke mos na lënë kohë t'i shohim me hollësi, si dhe pika të tjera që për ti sjellë deomos në këtë mbledhje nuk kanë respektuar procedurën si p.sh pr/vendimi për emërimin e drejtuesit të teatrit sepse ka ligje që rregullojnë këtë pjesë dhe ne si komision kemi gjykuar që kjo pikë nuk është e gatshme për tu sjell në këshill për miratim. Unë propozoj heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës së sotme. Edhe në lidhje me rregulloren mbi mbetjet urbane mendoj që duhen parë disa pjesë specifike, kurse për rregulloren për kundravajtjet administrative jam dakort.

Ndërsa për pikën lidhur me dhënien pa kundërshtim të ambjenteve të ish-konviktit "Safet Spahiu", në vlerësimin tim objekti në fjalë duhet të jepet me qira ose në emfiteozë pasi është ndërmarrje me status juridik sh.a, dhe nuk mund të jepet pa kundërshtim. Po ashtu edhe pika shtesë mendoj që nuk ka patur kohë të mjaftueshme për vlerësim nga ana jonë.

Z.Bashi mendon që pika 2. e rendit të ditës nuk duhet të shtyhet sepse kemi 8 vite pa një drejtues. Është bërë një punë e shkëlqyer nga znj.Rita Gjeka si drejtuese e komanduar, por duke ditur rëndësinë e këtij institucioni, mendoj që nuk duhet ta shtyjme më tepër këtë vendim.

Znj.Gjekaj si kryetare e komisionit të ligjeve shprehet se të gjitha pikat janë marr në shqyrtim nga komisioni por ajo dëshiron të bëjë një sqarim për qytetarët në lidhje me pikën 2

të rendit të ditës. Ligji 139 i vitit 2015 përcakton qartë që vendimi për zgjedhjen e drejtuesit të teatrit nuk është kompetencë e Këshillit bashkiak. Dhe për këtë komisioni ka vlerësuar unanimisht që Këshilli nuk e ka këtë tagër.

Hidhet në votim heqja nga rendi i ditës i pikës 2, ku rezultojnë 25 vota Pro, 15 Kundër, 0 Abstenim.

Nuk Miratohet

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë 33 vota Pro, 7 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2023”.*

Relaton **Z.Malocaj**, drejtor në drejtorinë e ndihmës ekonomike në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë __ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 3. Pr/ Vendim: *“Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane (MNU) Bashkia Shkodër”*

Relaton **Znj.Xhakoni**, përgjegjëse në drejtorinë e Shërbimeve publike në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur.

Kalohet në mendimin e komisionit; Znj.Gjekaj nga komisioni i ligjeve shprehet se është diskutuar për këtë rregullore edhe në mbledhjen e komisionit dhe është parë që sugjerimet e bëra në konsultimet publike ,si dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit janë marrë parasysh. Po ashtu jemi dakort edhe nga ana procedurale dhe vlerësojmë të drejtë miratimin e kësaj rregulloreje.

Znj.Duhani kërkon të dijë në lidhje me oraret, pasi ka vërejtur se përcaktohen oraret për qytetarët dhe bizneset për hedhjen e mbetjeve por a ka orare për makinat që bëjnë tërheqjen e tyre?

Përgjigjet **Znj.Xhakoni** e cila thotë se kemi një strukturë monitoruese për këtë dhe çdo administrator ose inspektor lagjeje përkatëse ka për detyrë të inspektojë frekuencën e evadimit të mbetjeve. Ajo shton se është me vend shqetësimi i paraqitur pasi kemi konstatuar disa raste abusive dhe operatori sipërmarrës ka marrë gjobë. Dhe sa herë të ketë shkelje do ketë penalitete.

Z.Galiqi shprehet në lidhje me kafshët që sorollaten në pikat e grumbullimit dhe nëpër qytet. A është menduar ndonjë zgjidhje për këtë.

Përsëri përgjigjet **Znj.Xhakoni**, që ka qenë problem më veshë kjo pjesë dhe prandaj është krijuar kjo rregullore për të rregulluar raste të tilla, kështu pronari i kafshës që ndot do gjobitet, kurse për kafshët nëpër qytet duhet të përgjigjet drejtoria përkatëse.

Znj.Shala thotë se vëren që rregullores i është bashkangjitur harta e pikave të grumbullimit, ajo do donte të dinte a ka pasur konsultim më parë me drejtorinë e Shërbimit publik sepse nëse pikat janë vendosur afër shpërndarjes së ujit të pijshëm ekziston mundësia për ndotje

dhe probleme të tjera të shëndetit. Duke vlerësuar shumë punën e bërë për krijimin e kësaj rregulloreje ajo kërkon të dijë a mendoni se është i mundur implementimi i saj kaq shpejt?

Znj.Xhakoni thotë që pikat e grumbullimit kanë qënë të përcaktuara me kohë, thjesht nga kërkesa e këshilltarëve ia kemi bashkangjitur hartën kësaj rregulloreje. Nuk ka shtim të pikave por vetëm heqje të disa pikave të mëparshme.

Z.Beci , Kryetari i bashkisë merr fjalën dhe sqaron se pikërisht për arsyen që pikat e vendosura lëvizeshin nga qytetarët dhe bizneset sipas interes ishte i domosdoshëm përcaktimi i saktë i tyre. Tek kjo rregullore parashikohet edhe marrja e masave për individët që zhvendosin koshat ose kontenierët.

Znj.Kavaja shprehet se ndërgjegjësimi i qytetarëve vazhdon të mbetet problematik. A kemi ne burimet e nevojshme monitoruese?

Znj.Xhakoni shprehet përsëri se rregullorja ka të parashikuar edhe ngritjen e strukturave konstatuese por konstatues mund të jetë edhe një qytetar. Është vendosur një numër telefoni në mënyrë që të jemi më afër me qytetarët. Për më tepër është menduar edhe për një plan komunikimi.

Z.Beci shprehet se mjeti më i mirë është sensibilizimi i njëjzve dhe presioni social për njëjzët që bëjnë këtë punë.

Z.Bjanku kërkon të dijë se kur hyn në fuqi kjo rregullore sepse ai mendon se për implementimin e disa pikave duhet kohë e mjaftueshme.

Përsëri **Znj.Xhakoni** shprehet se rregullorja hyn në fuqi pas reflektimit të saj në paketën fiskale sepse flitet për gjoba . Faza e njoftimit dhe ajo tranzitore ka filluar me kohë.

Z.Imeldi Sokoli kërkon të dijë sa është niveli i mbetjeve organike ? Gjithashtu ai sugjeron që Bashkia duhet të mendojë seriozisht krijimin e një pike kompostimi në mënyrë që të ulim ndjeshëm mbetjet organike dhe kostot.

Sqaron **Z.Luli**, i cili thotë se tani nuk ka më vend për diskutime sepse janë ezauruar të gjitha fazat e konsultimit, ankesave dhe sugjerimeve.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve :Z.Ndou në emër të grupit politik PS shprehet pro miratimit të pr/aktit, edhe Z.Sokoli , Znj.Shala dhe Z.Gjylbegaj shprehim dakortësi me pr/vendimin.

Hidhet në votim Pr/akti, ku rezultojnë 45 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika tjetër; Pr/Vendim: *"Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër"*

Relaton **Z.Lazri**, këshilltar pranë kabinetit të kryetarit sipas materialit të përgatitur.

Në emër të komisionit të ligjeve Znj.Gjekaj vlerëson rregulloren e paraqitur edhe nga ana ligjore, ajo thotë se komisioni gjykon që rregullorja duhet të kalojë për miratim.

Znj.Shkrela merr fjalën dhe vlerëson rregulloren por shton se flitet për penalitete të pronarëve të kafshëve, por kush do gjobitet në raste lëndimesh nga qentë endacakë? Tjetër pikë e rregullores është edhe gjobitja e personave që përhapin mbetjet nga kontenitorët por a

mund të gjobitet dikush që mbedh kanaqe për të mbijetuar? A ka politika Bashkia për punësimin e tyre?

Z.Lazri përgjigjet që përse i përket qenëve endacakë Bashkia Shkodër po bën një punë të mirë megjithatë kemi plot problematika akoma kurse në lidhje me politikat e punësimit, jam në dijeni që personave në fjalë i është ofruar punë por nuk është rënë dakort nga ana tyre.

Z.Bjanku kërkon të dijë se cila do jetë procedura që do ndiqet në rast ankimi nga qytetarët?

Z.Lazri përgjigjet se në rregullore nuk është parashikuar kjo pjesë por qytetarët mund ti drejtohen gjykatës administrative.

Z.Sokoli pyet sa është i mundur nga ana juaj informimi i qytetarëve për këtë rregullore?

Përsëri **Z.Lazri** përgjigjet se kjo rregullore do hyjë në fuqi në momentin e reflektimit të saj në paketën fiskale. Dhe pikë shumë e rëndësishme e rregullorës është edhe lehtësime për individët që paguajnë në kohë gjobat.

Z.Beci merr fjalën dhe thotë se lidhur me këtë ne mund të nisim një sensibilizim në të gjitha nivelet. Shihet shumë i drejtë informimi paraprakisht i popullatës.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe përgëzon punën e bërë për hartimin e konsultimin e kësaj rregulloreje. Ajo gjithashtu kërkon të shprehë qëndrimin e saj lidhur me hallkat e tjera zbatuese për të mos patur keqinterpretime. Ajo shton se duhet medemos të kemi informim të saktë të qytetarëve me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për të mos lënë shkas për abuzime të punonjësve zbatues të saj. Marr shkas nga një ankesë që më ka ardhur së fundmi nga qytetarë.

Z.Beci shprehet se nuk mund të prononcohemi për një rast të pakonfirmuar akoma. I është lënë detyrë administratorit të lagjes në fjalë verifikimi dhe padyshim që do merren masa.

Znj.Shala pyet nëse është parashikuar një nen lidhur me normat për zhurmat, lejeve për hapësirat publike dhe sa është afati i implementimit.

Z.Lazri përgjigjet se për zhurmat janë të ndara kompetencat sipas normave të caktuara të tyre.

Z.Pashuku kërkon të dijë nëse është parashikuar në buxhetin e ardhshëm të bashkisë edhe nevoja për një polic bashkiak në njësitë administrative pasi ka shumë problematika që është e pamundur të mbulohen nga administrator.

Z.Beci përgjigjet se nëse shihet si zgjidhje mund ta propozoni diçka të tillë dhe administrata do ta vlerësojë.

Kalohet në mendimet e kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen të gjithë dakort për miratimin e kësaj rregulloreje. Hidhet në votim Pr/akti, ku rezultojnë 45 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/Vendim: "Për dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim të një sipërfaqe prej 602 m²(kati parë) dhe 602 m²(kati dytë) objekti "ish Konvikti Safet Spahiu", në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku

Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e Qarkut Shkodër”

Relaton **Znj.Brikena Leqeja** sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë.

Nga ana e komisionit të çështjeve ligjore Znj. Gjekaj përsëri shprehet se komisioni është dakort për miratimin e këtij pr.akti pasi nga ana proceduriale është saktë.

Znj.Shala shprehet se në katin e dytë të kësaj godine janë qendrat shëndetësore , si do veprohet me to? Gjithashtu ajo shton se duke qënë se kjo ndërmarrje nuk është në varësi të Bashkisë por ë ministrisë a kemi ne të drejta të japim këtë asset tonin pa qera?

Znj.Leqeja përgjigjet se qendrat shëndetësore kanë një kontratë më Bashkinë , e cila është në përfundim por normalisht që do gjendet një sistemim për to në bazë rajonit ku ato ofrojnë shërbimet. Po ashtu për pyetjen e dytë ajo sqaron se ndërmarrja e ujësjellësit ka 100% capital public, ku 40% është e Bashkisë dhe po t’I referohemi katit përdhes të godinës është dhënë në të njëjtën procedurë për ADISA, duke kryer investime të cilat i mbesin përsëri Bashkisë.

Znj.Shkrela shprehet se si mund të vendosim për ndërmarrjen e ujësjellësit kur nuk e dimë akoma se ku do zhvendosen qendrat shëndetësore, që ofrojnë shërbim shëndetësor për një numër të madh banorësh të asaj zone? Për më tepër ajo nuk është aspak dakort që kjo godinë t’I jepet Ujësjellësit që lë aq shumë për të dëshiruar me shërbimet.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe shprehet se siç tha edhe drejtoresha, Bashkia Shkodër ka 40% aksione në këtë ndërmarrje, dhe si e tillë i bie që ajo t’I japë qera vehtes aq sa është edhe aksionere sepse është aset i saj. Nga ana proceduriale është krejtësisht e rregullt si kontratë hua-përdorimi.

Z.Beci shprehet se gjërat nuk ndodhin renda ditës. Ndërmarrja e ujësjellësit është një ndërmarrje disavjecare e menaxhuar nga Bashkia duke arritur gati në prag falimenti duke lënë Shkodrën pa ujë me ditë të tëra. Kjo vetëm për keqmenaxhim dhe borxhe. Po gjykohemi tani që sapo kemi filluar një rrugë të re menaxhimi.

Z.Bjanku thotë se duke parë VKM nr.54 nuk e di a është marr parasysh si referencë për dhënien pa kundërshtpërblim të këtij ambjenti?

Përgjigjet **Znj.Leqeja**, se jemi referuar kodit civil për këtë(kontratë pa kundërshtpërblim) duke ditur edhe prevalencën e tij. Për më tepër në këtë rast nuk jemi në kushtet e VKM-së.

Z.Galiqi shprehet nuk është kundra dhënies së këtij ambjenti ndërmarrjes por në mbështetje me Znj.Shestani ai propozon që së pari duhet gjetur një sistemim për qendrat shëndetësore pastaj të jepet me qera.

Edhe **Z.Sokoli** mbështet propozimin duke gjykuar se ky pr/vendim duhet shtyrë deri në sistemimin e qendrave aty, duke ditur që gjetja e ambjenteve për qendrat shëndetësore është 100% kompetencë e Bashkisë. Për më tepër ai shton se nuk është aspak dakort me dhënien pa kundërshtpërblim të aseteve të Bashkisë.

Znj.Duhani pyet se nëse duke sjell ndërmarrjen më afër a do kemi përmiresim të shërbimeve?

Znj.Kopliku merr fjalën dhe shprehet se ndan të njëjtin mendim me Znj.Shala dhe Z.Galiqi por ka një pyetje: Duke qënë se UKSH ka tashmë dy ambjente, një kohë që qendrat

shëndetësore nuk kanë gjetur akoma një sistemim pse është kaq urgjente që kjo godinë t'i jepet kësaj ndërrmarrjeje?

Z.Shkjau shprehet se arsyet tashmë u thanë dhe beson që nuk ka nevojë më për diskutime.

Z.Gjylbegaj shprehet se u diskutua për dhënie në përdorim ambjenti duke ditur që pas 10 vitesh do kemi një godinë të investuar. Ai mendon që si kusht të vendoset në kontratë lirim i godinës pranë Kolpingut më parë pastaj të bëhet miratimi gjithmonë pas sistemimit të qendrave shëndetësore. Propozoj ta shtojmë këtë si kusht në këtë vendim.

Z.Beci shprehet se është plotësisht dakort me propozimin për kusht sepse të gjitha sa u tha janë detyrimë të Bashkisë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 32 vota Pro, 10 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika 5. e rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023"*

Relaton **Znj.Kruja**, drejtoreshë e drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Shkodër. sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD shprehin dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika 6. e rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*.

Nuk ka nevojë për relatin kalohet te mendimet e kryetarëve të grupeve politike, të cilët janë dakort me miratimin e këtij pr.vendimi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 42 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën tjetër: Pr/ Vendim: *"Për disa ndryshime në VKB nr.27, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër"*i ndryshuar

Relaton **Znj.Gjyrezi**, drejtoreshë e drejtorisë së Kulturës dhe Sportit në Bashkinë Shkodër. sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku shpreh dakortësi dhe vlerësim për përzgjedjen e anëtarëve të këtij komisioni por ka rezerva lidhur me shpërblimin e tyre.

Znj.Gjyrezi sqaron se pagesa është e caktuar me VKM.

Edhe Znj.Shkrela vlerëson figurat e zgjedhura të këtij komisioni vlerësues.

Po ashtu edhe **Z.Doçi** propozon të shihet mundësia e rritjes së shpërblimit për keto personalitete të shqyara të qytetit.

Z.Beci shprehet krejtësisht dakort por do shihet mundësia nga ana ligjore për këtë.

Edhe **Z.Galiqi** shpreh vlerësimin e tij por kërkon që anëtarët e këtij komisioni të faktorizohen për atë çka vendosin pasi precedenti ka dëshmuar të kundërtën.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 42 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikë 9. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me VKB Nr.71 datë 27.12.2022 “ Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”*

Relaton përsëri **Znj.Kruja** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku kërkon të dijë nëse është marr në konsideratë se projektet duhen përjashtuar nga pagesa e TVSH-së?

Sqaron **Z.Mema** duke thënë se akoma nuk kanë dalë udhëzimet zbatuese që përjashtojnë projektet e financuara nga BE nga pagesa e TVSH-së.

Znj.Bajraktari kërkon të dijë se sa është numri i fëmijëve përfitues nga ky program dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes?

Përgjigjet **Znj.Kruja**, e cila thotë se përfitues janë 30 fëmijë të komunitetit Rom-Egjiptianë.

Kalohet te mendimet e kryetarëve të grupeve politike, të cilët janë dakort me miratimin e këtij pr.vendimi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 43 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 10. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të “Agjencia Rrenc” me nr.pasurie 19/2, ZK 3168, indeks hartë K-34-64-(210-B), me sipërfaqe prej 31,165m², nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër”.*

Relaton përsëri **Znj.Leqejza** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Z.Ndou** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe **Znj.Shala** për grupin BF dhe **Z.Gjylbegaj** për grupin PD shprehin dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 44 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 11. Pr/ Vendim: *“Për krijimin e komisionit të përkohshëm të Këshillit bashkiak Shkodër, “Për kriteret dhe procedurën e dhënies së titujve vendorë të nderit dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territotoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Luli** sipas materialit të përgatitur. Vijohet me votimin e këtij Pr/akti, ku rezultojnë 44 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën shtesë të rendit të ditës: *Pr/Vendim: Për një ndryshim në VKB nr.71 datë. 27.10.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar.*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Luleta** sipas materialit të përgatitur. Për më tepër sqaron **Z.Beci** edhe njëherë në lidhje me ndryshimin e kërkuar. Duke parë kërkesën e qytetarëve për vazhdimin e korsive të biçikletave dhe duke mos dashur të ndërpresim punën e nisur deri në miratimin e buxhetit të ardhshëm kërkojmë mirkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Znj.Gjekaj merr fjalën dhe shprehet plotësisht dakort por si kryetare e komisionit për çështjet ligjore e ndjen për detyrë të sqarojë publikun në lidhje me rregulloren. Ajo dëshiron të theksojë që ky pr/vendim ka ardhur për shqyrtim vetëm gjysëm ore para mbledhjes së komisionit prandaj ajo kërkon që kjo gjë të mos përsëritet më sepse është shkelje e ligjit për qeverisjen vendore. Ajo kërkon zbatim e pikës 10 të nenit 57 të saj.

Sqaron **Z.Luli** duke thënë se në bazë të nenit 51 të rregullores së Këshillit bashkiak, Kryetari i bashkisë ka të drejtë të sjellë në rendin e ditës materiale që shihen me prioritet. Vijohet me votimin e këtij Pr/akti, ku rezultojnë 43 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Znj.Shala** e cila ka një pyetje për kryetarin e bashkisë, nëse është në dijeni që ndërrmarrja e Ujësjellësit ka kërkuar rritje tarifimimi për qytetarët dhe si kryetar i asamblesë a e dini që kjo ndërrmarrje tashmë është kthyer në ndërrmarrje private në shërbim të një individi? Ajo tregon edhe një rast personal konkret abuzimi, për të cilën ajo ka bërë edhe një shkresë informuese. Ajo kërkon ndërhyrjen e Kryetarit të bashkisë në interes të institucionit që drejton dhe të qytetarëve të Shkodrës, qofshin këto të majte ose të djathtë.

Z.Sokoli kërkon të shprehë indinjatën e tij lidhur me banorët e Thethit dhe gjithashtu kërkon që drejtues abuziv të japin llogari në Këshill për ankesa dhe probleme të tilla.

Edhe **Znj.Pode** shpreh shqetësimin e banorëve të Zogajve lidhur me shtimin e frekuencës për transportin publik të kësaj zone.

Z.Doçi merr fjalën përsëri dhe ka një pyetje për Kryetarin **Z.Beci**: A mendoni që korsitë e biçikletave kanë qënë të "dëmshme" për bizneset?

Z.Beci përgjigjet që mendon që korsitë kanë qënë të dobishme për qytetin.

Edhe **Znj.Bajraktari** ka një shqetësim, ajo thotë se me ndryshimin e sensit të lëvizjes në blvd.Mehmet Pashë Plaku, ka probleme me trafikun pasi aty ka 4 shkolla. Ajo propozon vendosjen e fashave të orarit.

Z.Beci shprehet se shqetësimi është i drejtë dhe po punohet për ti dhënë zgjidhje. Paralelisht po punojmë edhe për të sjellë një projekt me standarte evropiane për mobilitetin e qytetit.

Përsëri **Znj.Bajraktari** propozon edhe parashikimin në buxhet të zbukurimeve të qytetit për muajin e Ramazanit.

Përgjigjet **Z.Beci** që kërkesa është shumë e drejtë dhe do shihet mundësia patjetër.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe thotë se ajo ka bërë edhe një shkresë për informacion drejtuar Bashkisë duke qenë se kërkon të dijë planin e ekzekutivit për implementimin e plotë të adresarit. Gjithashtu ajo shpreh ankesat e shumë qytetarëve në lidhje me pagesat e gjobave të policisë bashkiake, Cilat janë kanalet e mundshme për kryerjen e pagesës së tyre pasi qytetarët janë konfuz kur ato drejtohen në bankat e nivelit të dytë aq më tepër kur kto të fundit mbajnë edhe komisionin e tyre.

Z.Behri përgëzon punën e kryer për shtrimin e rrugës së gjerë por kërkon të dijë nëse mban dikush përgjegjësi për gropën e hapur pas dy ditësh? Edhe në rastet kur UKSH dhe OSSHE kryen riparime në rrugë dhe i lë të hapura me muaj të tërë duke krijuar edhe probleme me qarkullimin.

Znj.Pode shpreh një tjetër shqetësim komunitar në lidhje me tymin që krijohet nga pjekja e gështenjave në rrugë.Mendon se duhet gjetur një zgjidhje për këtë.

Z.I.Sokoli në emër të grupit të partisë demokratike thotë se kanë bërë një shkresë lidhur me livizshmërinë në qytet. Duhet bërë transparent kjo timeline e projektit mbi planin e mobilitetit.

Znj.Duhani kërkon të dijë nëse mendohet të kryhen ndërhyrje fasadash edhe në hyrje të Shkodrës?

Znj.Kopliku merr fjalën përsëri dhe kërkon që numri i telefonit për qytetarët në lidhje me ankesat e tyre të bëhet transparent. Dhe gjithashtu kërkon që t'i vihen në dispozicion projektet dhe lista e prioritetve të dala nga dëgjesat publike.

Z.Bjanku ngre një shqetësim në lidhje me objektet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Duhet medeomos të ndërhyhet pasi rrezikohet humbja e tyre.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, Kryetari i Këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 26.10.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 10 faqe

Zbardh procesverbalin

Irma Sulishti



Sekretar

Denis LESH



KRYETAR

Oltion KULLI

